

PREJARDHJA DHE ZHVILLIMI I VETËQEVERISJES LOKALE

Vetëqeverisja lokale së pari paraqitet në qytet (komunat) mesjetare, të cilat këtë të drejtë e “blejnë” nga sundimtarët. Në periudhën e luftës kundër sistemit feudal ideja e vetëqeverisjes lokale vjen duke u transformuar. Në kushtet e organizimit të aparatit shtetëror mbi baza centraliste, nëpërmjet të kërkesës për vetëqeverisje lokale, në fakt, popullata i kundërvihet aparatit shtetëror të centralizuar të absolutizmit feudal. Arsyetimin e vet kjo ide e gjen në doktrinën e drejtës natyrore.

Pas fitores, borgjezia e sëndërton idenë e vetëqeverisjes lokale, kështu që në njesitë caktuara lokale formohen organet e vetëqeverisjes lokale, si forma institucionale të pjesmarrjes së shtetasve në ushtrimin e pushtetit lokal, forma këto që, në pjesën dërmuese të shteteve demokratike, funksionojnë edhe sot me kompetenca pak sa të reduktuara, sidomos në ato shtete që shquhen për nga centralizmi i fortë i aparatit shtetëror.

Vetëqeverisja lokale, si anticentralizëm, gjatë zhvillimit të saj ka hasur në rezistencë, sidomos në shtetet rreptësisht të centralizuara. Në shtetet e tilla parreshtur janë paraqitur tendenca për kufizimin, madje edhe mohimin, e të drejtave të organeve të vetëqeverisjes lokale në ushtrimin e pushtetit lokal.

Sistemi anglez i vetëqeverisjes lokale paraqet sistemin më të vjetër dhe më komplet të vetëqeverisjes lokale në botë. Institucioni themelor i pushtetit lokal është këshill lokal. Për nga mënyra e zgjedhjes dhe përbërja partiake, këshilli lokal rëndom i ngjan dhomës së Komunave (Dhomës së Poshtme). Ai zgjedhë çështjet themelore politike, financiare, ekonomike dhe komunale në kompetencë të bashkisë. Në krye të Këshillit është kryetari (“mer”), pa funksione të veçanta ekzekutive, si person reprezentativ, i cili paraqitet si kryetar i këshillit dhe i bashkisë vetëm në çështjet publike – “sociale”. Këshilli formon këshilla dhe komitete të shumtë, numri i të cilëve arrin edhe deri njëzet.

Puna në komitete dhe në këshilla ushtrohet pa pagesë. Ndërsa punët profesionale i ushtron i ashtuquajtur “civil service”, sikurse edhe në Qeverinë qendrore të Anglisë. Nëpunësit profesional i emëron Këshilli. Ata duhet të jenë

politikisht neutral dhe të sigurojnë punën profesionale, teknike, administrative e të ligjshme të institucioneve dhe të shërbimeve të këshillit.

Ky tip i vetëqeverisjes lokale i para Luftës së Dytë botërore është përhapur dhe zhvilluar edhe në Zvicër, Belgjikë, Holandë, Suedi dhe në vende të tjera të Evropës si dhe SHBA gjatë shekullit XVIII.

Nën ndikimin e procesit të centralizimit ekonomik e politik, edhe në SHBA, sikurse në përgjithësi në shtetin bashkëkohor të zhvilluar, në mënyrë të ngjashme si në Angli, vetëqeverisja lokale është “ pasuruar “edhe me elemente të decentralizimit. Këto elemente diku vijnë në shprehje në aspektin formal-juridik, e në disa vende vetëm praktik-faktik.

Përpos këtyre, në të kaluaren janë paraqitur edhe tipe të tjerë të vetëqeverisjes lokale. Një nga ta shumë i lashtë edhe në zhdukje e sipër, është vetëqeverisja lokale që e ushtrojnë kuvendet e zgjedhësve, karakteristikë për njesitë e vogla lokale në shumë vende (e veçmas në Zvicër në komunat rurale) në procesin e luftës kundër absolutizmit. Ky tip, si formë e demokracisë së drejtpërdrejtë lokale ka edhe elemente të sistemit përfaqësues. Për të është karakteristike se funksionet ekzekutive të pushtetit i ushtron grupi i shtetasve të zgjedhur drejtpërdrejtë nga populli. Në krye të këtij “organi ekzekutiv” gjendet individi me autoritet, i cili, në mënyrë pak a shumë të pavarur, ushtron funksionet ekzekutive. Një tip i vetëqeverisjes lokale, relativisht i ri, i cili është paraqitur në nivelin e qytetit në disa vende, e sidomos në SHBA, është ai i emëruar si sistem i “ menaxherit ” (drejtorit) të qytetit. Këshilli i qytetit e zgjedhin shtetasit me të drejtë të zgjedhjes në territorin e qytetit. Këshilli vendos për çështjet më të rëndësishme nga lëmi i rregullimit dhe zhvillimit të qytetit. Përpos Këshillit, shtetasit zgjedhin drejtpërdrejtë drejtorin e qytetit, i cili është nisëtor i të gjitha vendimeve dhe i planeve që i miraton Këshilli dhe i vetmi bartës i të gjitha funksioneve ekzekutive të pushtetit të qytetit. Kjo formë e vetëqeverisjes lokale është zhvilluar nën ndikimin e sistemit presidencial dhe dukshëm është larguar.

Për dallim nga vendet demokratike, në vendet socialiste (me përjashtim të RSFJ nga viti 1955, kur është zbatuar “sistemi komunal”, e sidomos pas miratimit të Kushtetutës të vitit 1974) vetëqeverisja lokale është konsideruar si formë e

“sistemit borgjez”, si formë e zhveshjes së klasës punëtore dhe i shtresave të tjera punonjëse na ushtrimi i pushtetit etj.

ZHVILLIMI HISTORIK I VETËQEVERISJES LOKALE NË KOSOVË

Vetëqeverisja lokale në Kosovë në periudhën 1946 – 1963

Sa i përket konceptit të qeverisjes lokale në periudhën 1946-1963, në Kosovë është aplikuar sistemi jugosllav i decentralizimit, ku organet lokale të pushtetit vendosen në raporte hierarkike dhe subordinuese në raport me organet qendrore. Si njësi lokale, përpos komunave, paraqiten edhe rrethet, të cilat kishin funksione të gjera në ushtrimin e pushtetit. Numri i komunave ishte relativisht i madh, kurse statusin e rretheve e kishin kryesisht qytetet e mëdha. Funksionet e njësisve lokale të pushtetit caktoheshin me Kushtetutë, me ligj dhe me statutet e rretheve dhe komunave. Një bartje të ndjeshme të kompetencave të organeve lokale të pushtetit e përcakton Ligji Kushtetues i vitit 1953, i cili fillon të sendërtojë parimin e ndërtimit të pushtetit nga poshtë në lart. Sa i përket mëvetësisë së organeve lokale të pushtetit në Kosovë, ato kanë qenë nën hierarki të dyfishte ndaj organeve qendrore krahinore dhe ndaj organeve republikane të Serbisë.

Vetëqeverisja lokale në periudhën 1963 -1974

Me miratimin e Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1963 dhe të kushtetutave të republikave socialiste në të njëjtin vit, Kosova nxori Statutin e saj të tretë dhe njëkohësisht të fundit, në vitin 1963. Ky statut nuk solli ndonjë risi të veçantë sa i përket pozitës kushtetuese juridike të Kosovës. Të drejtat dhe detyrat e Kosovës, për dallim nga Kushtetuta e RFPJ-së e vitit 1946, tani përcaktohen me

Kushtetutën e RS të Serbisë të vitit 1963. Sipas nenit 129 të kësaj kushtetute, krahinat autonome kanë rregulluar çështjet me interes të përgjithshëm, sidomos në lëmin e ekonomisë, të arsimit, kulturës, mbrojtjes shëndetësore, sigurimit social, marrëdhënieve komunale dhe atyre të banesave, etj. Krahinat autonome, sipas kësaj kushtetute, kanë nxjerrë buxhetin dhe planet shoqërore të tyre, kanë mundur të themelojnë organizata punuese dhe organizata të tjera vetëqeverisëse për ushtrimin e punëve dhe detyrave të veta, janë kujdesur për mbrojtjen e rendit dhe të qetësisë publike, si dhe kanë ushtruar punët e tjera të përcaktuara me ligjin republikan.

Përcaktimi i të drejtave dhe detyrave të Kosovës me Kushtetutën e RS të Serbisë (e jo me atë federative) ishte rezultat i procesit të shndërrimit të njësive autonome në „kategori republikane“. Me këtë ato humbën atributin si element konstituiv i federalizimit, të cilin atyre ua garantonte Kushtetuta e RFPJ-së e vitit 1946. Të drejtat dhe detyrat e Kosovës tani nuk trajtoheshin si autorizime burimore, të cilat i garantonte Kushtetuta federative, por si tërësi autorizimesh, të cilat Serbia i ka bartur në të. E tërë kjo ka pasur si pasojë zbehjen e dukshme të mëvetësisë së Kosovës dhe vënien e pozitës së saj në suaza të autonomisë së thjeshtë administrative-territoriale.

Zbehja e autonomisë së Kosovës, pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1963, ndikoi dukshëm edhe në varshmërinë e organeve lokale në Kosovë ndaj organeve të Republikës së Serbisë. Tani në raportet mes këtyre organeve dominojnë parimet e centralizimit, subordinimit dhe varshmërisë institucionale. Sa i përket organizimit territorial, nuk kishte ndonjë risi, pra edhe më tutje funksiononin dy nivele të pushtetit lokal: ai i rretheve dhe ai i komunave.

VETËQEVERISJA lokale në periudhën 1974 – 1990

Nxjerrja e Kushtetutës së ish-RSFJ-së në vitin 1974 vazhdoi procesin e avancimit të pozitës kushtetuese të Kosovës në kuadrin e federalizimit jugosllav. Kosova, me dispozitat e kësaj kushtetute, u përcaktua si njësi autonome politike territoriale dhe si element konstituiv i federalizimit.

Kushtetuta e vitit 1974, duke promovuar konceptin e një federate të decentralizuar, vendos komunën në epiqendër të ndërtimit të sistemit politik. Duke promovuar konceptin e VETËQEVERISJES socialiste, Kushtetuta përcakton komunën si celulë themelore të ndërtimit të pushtetit dhe të realizimit të të drejtave të klasës punëtore dhe të gjithë njerëzve punonjës.

Funksionet e komunës, sipas Kushtetutës, janë mjaft të gjera dhe të rëndësishme dhe përfshijnë të gjitha çështjet e karakterit ekonomik, social dhe politik me rëndësi për qytetarët. Si njësi më e ulët lokale e pushtetit ishin bashkësitë lokale ku ushtroheshin punët e ndryshme administrative. Ndërtimi i pushtetit nga poshtë në lart, shihet më së miri në faktin se komuna ishte njësi deleguese për kuvendet e të gjitha bashkësive shoqërore-politike, prej krahinave e deri në Federatë.

VETËQEVERISJA lokale në periudhën 1990-1999

Rrënimi i pozitës së Kosovës në bazë të Kushtetutës së vitit 1974

Rrënimi kundërkushtetues i pozitës kushtetuese të Kosovës, të përcaktuar në Kushtetutën e vitit 1974, u bë me një mori veprimesh dhe aktesh kundërkushtetuese, në të cilat pushteti serb, duke filluar nga viti 1981 e deri më sot, *de facto* rrënoi çdo atribut kushtetues dhe politik, me të cilin shprehej individualiteti territorial dhe politik i Kosovës.

Krahas me rrënimin e pozitës kushtetuese të Kosovës dhe suprimimin e organeve kushtetuese të Kosovës, pushteti serb rrënoi edhe pushtetin lokal në Kosovë në të gjitha komunat me shumicë shqiptare, duke suprimuar punën e kuvendeve komunale dhe të organeve të tjera ekzekutive dhe gjyqësore në nivelin lokal. Ky proces u zhvillua me skenar të njëjte në bazë të legjislacionit

diskriminues, e në radhë të parë në bazë të Ligjit për veprimin e organeve republikane serbe në rrethana të jashtëzakonshme dhe të veçanta. Duke u bazuar në këtë ligj diskriminues, organet serbe nxorën vendime për suprimimin e kuvendeve komunale në komunat veç e veç dhe në vend të tyre vendosen administratën e dhunshme serbe, e cila, duke bërë spastrimin etnik me largimin e punëtorëve shqiptarë në administratën komunale, vendosi një sistem okupues të qeverisjes përmes ligjeve serbe, të cilat zbatonin politikën okupuese të pushtetit serb.

Organizimi dhe funksionimi i pushtetit lokal sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës të vitit 1990

Komuna është njësi territoriale, në të cilën qytetarët realizojnë vetadministrimin, në harmoni me kompetencat e tyre të caktuara me statutin e komunës.

Republika, me ligj, mund t'ia besojë komunës kryerjen e disa punëve. Komuna, në bazë dhe në suaza të Kushtetutës dhe të ligjit, nëpërmjet organeve të veta kryen këto funksione:

1. Miraton programin e zhvillimit, planin urbanistik, buxhetin dhe llogarinë përfundimtare;
2. Siguron zhvillimin e veprimtarive komunale dhe me dispozitat e veta cakton kriteret e përgjithshme për ushtrimin dhe kryerjen e tyre;
3. Përkujdeset për ndërtimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e rrugëve lokale si dhe të objekteve të tjera publike, të cilat janë me interes komunal;
4. Rregullon shfrytëzimin e tokës ndërtimore dhe të hapësirës afariste;
5. Përkujdeset për përmbushjen e nevojave të qytetarëve në lëmin e kulturës, arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, të kulturës fizike, zejtarisë, turizmit dhe të hotelerisë, të mbrojtjes e përparimit të mjedisit jetësor dhe në sfera të tjera të përcaktuara me statutin e komunës dhe me akte të tjera të organeve komunale me interesa të drejtpërdrejta për të gjithë qytetarët, të cilët jetojnë në territorin e komunës;

6. Siguron zbatimin e dispozitave komunale, si dhe të ligjeve dhe të dispozitave të tjera republikane, realizimi i të cilave i është besuar komunës dhe

7. Formon organe, organizata dhe shërbime të komunës. Komunës i takojnë të hyrat e përcaktuara me ligj.

Mjetet për përmbushjen e nevojave të qytetarëve mund të sigurohen edhe me vetëkontribut, në pajtim me ligjin. Për zbatimin e vetëkontributit qytetarët vendosin me referendum.

Komuna ka statutin me të cilin rregullohen funksionet e komunës, organizimi i organeve komunale, si dhe çështjet e tjera me interes për komunën. Statutin, si akt më i lartë juridik, e nxjerr Kuvendi i Komunës. Qyteti i Prishtinës është njësi e posaçme territoriale.

Qyteti ka statutin me të cilin rregullohen funksionet e qytetit, organizimi i organeve të qytetit, si dhe çështje të tjera me interes për qytetin. Statutin e qytetit e nxjerr Kuvendi i Qytetit.

Kuvendin e Qytetit e përbëjnë deputetët e zgjedhur në zgjedhjet e lira, të drejtpërdrejta, me zgjedhje pluraliste dhe me vota të fshehta. Qyteti i Prishtinës kryen punët e komunës të përcaktuara me Kushtetutë.

Pas miratimit të akteve burimore kushtetuese dhe politike me të cilat u shpall Republika e Kosovës, në vitin 1992 u mbajtën zgjedhjet e para parlamentare dhe presidenciale, në të cilat u zgjodh Kuvendi i Kosovës dhe Kryetari i Republikës. Me këtë rast nuk u organizuan zgjedhjet për organet lokale. Sa i përket funksionimi të organeve lokale të pushtetit në periudhën e okupimit, duhet theksuar se, ndonëse kishte disa përpjekje, nuk kishte as kushte e as ndonjë strategji të mirëfilltë politike për ndërtimin e strukturave lokale të pushtetit sipas përcaktimeve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Elementet e pakta të pushtetit lokal vëreheshin në përpjekjet e aty-këtushme të disa kuvendeve komunale që pas subrimimit të tyre nga organet serbe të mbajnë disa mbledhje në objektet private dhe disa përpjekje që me disa vendime të rregullohet në mënyrë paralele pushteti lokal. Këto përpjekje nuk ishin edhe aq të organizuara, sepse kuvendet komunale, pas suprimimit, vepronin në kushte ilegale, nuk kishin instrumente për zbatimin e vendimeve të tyre dhe nuk kishin

buxhet për zhvillimin e veprimtarisë së tyre. Në këtë drejtim kohë pas kohe Qeveria e Republikës së Kosovës, që vepronte në ekzil, kishte bërë përpjekje për të ndihmuar funksionimin paralel të organeve lokale të pushtetit, por nuk kishte një strategji të mirëfilltë se si duhej të funksiononte ky segment i pushtetit, që ishte rezultat i kushteve të okupimit të Kosovës dhe veprimit të kufizuar të institucioneve të Republikës së Kosovës në këto kushte.

Funksionimi dhe organizimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë në periudhën 1999 – 2000

Qeveria e Përkohshme e Kosovës bëri përpjekjet e para për institucionalizimin e jetës në Kosovë në përgjithësi, e në këtë kontekst edhe për themelimin dhe funksionimin e pushtetit lokal. Pas rikthimit të popullit shqiptar nga eksodi që ai kishte marrë pas deportimit nga forcat serbe, lindi nevoja për themelimin e organeve lokale të pushtetit, për organizimin e jetës në komuna dhe për marrjen e vendimeve me interes për qytetarët. Për këtë qëllim, Qeveria e Përkohshme bëri përpjekjet e para për konsolidimin e pushtetit lokal në komunat e Kosovës. Me qëllim të mbulimit të vakuimit fillimisht kjo qeveri emëroi kryetarët e komunave dhe bartës të tjerë të funksioneve ekzekutive në komuna. Kryetarët e komunave morën udhëheqjen e komunave dhe formuan organe të tjera komunale me qëllim të krijimit të rendit dhe funksionimit të politikave publike në nivel komunal. Në këtë kohë, në nivel të Qeverisë së Përkohshme funksiononte Ministria e Pushtetit Lokal, që bënte përpjekje të koordinonte politikat e funksionimit të pushtetit lokal në Kosovë.

Me qëllim të krijimit të bazës juridike për funksionimin e pushtetit lokal, Qeveria e Përkohshme miratoi Dekretligjin për Pushtetin Lokal, i cili përcaktonte mënyrën e funksionimit të pushtetit lokal në Kosovë. Sipas këtij dekretligji, komunat përbëjnë njësinë themelore territoriale, në të cilën qytetarët realizojnë interesat e përbashkëta.

Pas krijimit të strukturave të përbashkëta administrative, siç ishin Këshilli i Përkohshëm Administrativ (KPA), Këshilli Transitor i Kosovës (KTK) dhe departamentet administrative, u shpërbë Qeveria e Përkohshme e Kosovës dhe

të gjitha strukturat e tjera paralele të Republikës së Kosovës. Me këtë edhe pushoi së funksionuari Ministria e Pushtetit Lokal brenda QPK-së dhe u themelua Departamenti i Pushtetit Lokal brenda strukturës së UNMIK-ut. Ky departament udhëhiqej nga dy bashkëkryesues, një ndërkombëtar dhe një lokal. Detyrë e këtij departamenti ishte organizimi i pushtetit lokal deri në mbajtjen e zgjedhjeve të para lokale në Kosovë, kur edhe fillon ndërtimi i institucioneve demokratike në Kosovë.

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QEVERISJES LOKALE NË periudhën 2000-2006

DISA SHËNIME TË PËRGJITHSHME DEMOGRAFIKE DHE TERRITORIALE TË KOMUNAVE TË KOSOVËS

Kosova ka një territor prej 10.887 km² . Sipas disa parashikimeve dhe vlerësimeve jozyrtare, Kosova ka një popullsi prej 2.500.000 banorësh. Sipas studimit të Entit të Statistikës të Kosovës, llogaria më e përafërt është 1.900.000 banorë.

Kosova ka 30 komuna me numër të banorëve, që sillet nga 4.000 deri 500.000 banorë.

Dendësia e popullsisë është 175 banorë për km² dhe është një ndër më të mëdhatë në Evropë.

Kufijtë e komunave të Kosovës janë të përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 43/2000 për numrin, emrin dhe kufijtë e komunave, të datës 27 korrik, më pas e amendamentuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 36/2004 e datës 8.9.2004 dhe Urdhëresa Administrative 23/2004.



Sipas Rregullores nr. 45/2000 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës dhe Rregullores së UNMIK – ut 30/2007 mbi ndryshimin e Rregullores nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, Kosova ka 30 komuna. Siç shihet, këto rregullore vetëm kanë trashëguar dhe sanksionuar organizimin territorial të Kosovës dhe ka shtuar një komunë të re (komuna e Zveçanit).

Numri i banorëve nëpër komuna dallon në masë të madhe. Ka komuna jashtëzakonisht të mëdha dhe jashtë standardeve të vendeve evropiane, të cilat kanë status të njëjtë juridik me komunat e vogla, që numerikisht nuk kanë 1% në krahasim me komunat e mëdha.

Në vijim do të japim shifrat e numrit të banorëve sipas përkatësisë nacionale dhe moshës, sipas të dhënave nga “Statistikori vjetor” i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Tabela nr.1

| Emri | Numri i vlerësuar i banorëve për komuna | Numri i vlerësuar i pakicave në komuna | Numri i vlerësuar i banorëve nën 25 vjeç në komuna | Numri i vlerësuar i banorëve mbi 65 vjeç | Numri i vlerësuar i përqindjes së pakicave | Numri i supozuar '2 milionë' | NDF %** | Numri i fshatrave |
|------------------|---|--|--|--|--|------------------------------|---------|-------------------|
| Prishtinë | 328187 | 8450 | 12100 | 86000 | 2.57% | 35800 | 4.10 | 48 |
| Podujevë | 125780 | 794 | 54500 | 4275 | 0.63% | 10460 | 0.40 | 79 |
| Prizren | 250000 | | | | | 19680 | 22.8 | 76 |
| Suharekë | 85000 | 500 | 45750 | 1300 | 0.59% | 71600 | 1.00 | 41 |
| Gjakovë | 151800 | 7000 | 78936 | 6072 | 4.61% | 10280 | 4.30 | 92 |
| Pejë | 160000 | | | | | 10280 | 11.0 | 94 |
| Mitrovicë | 142200 | 16500 | 39700 | 9850 | 11.6% | 98400 | 14.3 | 49 |
| Gjilan | 141000 | 11000 | | | 7.8% | 98400 | 19.0 | 63 |
| Ferizaj | 144351 | | 8723 | 5894 | 3.21% | 99200 | 3.40 | 46 |
| Malishevë | 65000 | 35 | | | 0.05% | 46600 | 0.00 | 44 |
| Glllogoc | 73847 | | 33230 | 3545 | 0.00% | 53600 | 0.00 | 37 |

| | | | | | | | | |
|----------------------|--------|-------|-------|-------|------------|-------|------------|----|
| Lypjan | 87660 | 12670 | 29054 | 7735 | 14.45 % | 67000 | 16.0 0% | 72 |
| Rahovec | 75000 | 1600 | 45000 | 3750 | 2.13% | 56400 | 3.10 % | 35 |
| Deçan | 65000 | 500 | 26000 | 1500 | 0.77% | 44800 | 1.30 % | 42 |
| Istog | 64342 | 3869 | | | 6.01% | 39400 | 5.40 % | 50 |
| Klinë | 59035 | 5200 | - | - | 8.81% | 39400 | 3.50 % | 54 |
| Skënderaj | 72600 | 478 | | | 0.66% | 50000 | 1.00 % | 50 |
| Vushtrri | 104804 | 3627 | | | 3.46% | 67000 | 5.60 % | 66 |
| Kaçanik | 55000 | 7 | 35860 | 19140 | 0.01% | 38400 | 0.00 % | 42 |
| Kamenicë | 57000 | 9600 | 33000 | 24000 | 16.84 % | 49200 | 24.0 0% | 76 |
| Viti | 68633 | 3380 | | 2700 | 4.9% | 45600 | 8.00 % | 43 |
| Fushë-Kosovë | 41412 | 5973 | 17830 | 1692 | 14.42 % | 31400 | 19.0 0% | 16 |
| Obiliq | 32000 | | | | | 23200 | 19.0 0% | 20 |
| Shtime | 35000 | 700 | 15645 | 1295 | 2.00% | 25000 | 3.00 % | 23 |
| Dragash | 42700 | 13208 | | | 30.93 % | 31400 | 41.3 0% | 36 |
| Leposaviq | | | | | | 17000 | 5.80 % | |
| Zubin Potok | | | | | | 13400 | 11.6 0% | |
| Zveçan | | | | | | 14400 | 5.90 % | |
| Novobërdë | 3900 | | | | | 4400 | 49.0 0% | 14 |
| Shterpcë | 16000 | 4500 | 8500 | 7500 | 28.13 % | 9800 | 34.0 0% | 16 |
| Hani i Elezit | 10000 | | 6000 | 200 | | | | 11 |
| Junik | 12500 | 5 | 500 | 2500 | | | | 5 |
| Mamushë | 6000 | | | | | | | |

Dhe, po qe se këtë e krahasojmë me numrin e banorëve dhe të popullsisë në disa shtete sipas të dhënave të Këshillit të Evropës nga viti 1998, atëherë

shihet qartë se komunat e Kosovës kanë popullatë numerikisht të madhe dhe se ofrimi i shërbimeve në këto kushte është mjaft i vështirë.

| Vendet | Numri I komunave (mesatarja e popullsisë) | Numri I rrethit të dytë të autoriteteve (mesatarja e popullsisë) | Numri i rajoneve/shteteve federale(mesatarja e popullsisë) |
|------------------|--|---|---|
| Austria | 2.337 (3.200) | - | 9 (839.500) |
| Belgjika | 589(17.200) | 19 (917.900) | 3 (3.376.900) |
| Bullgaria | 262 (31.615) | - | 28 (295.829) |
| Franca | 36.551 (1.600) | | |
| Gjermania | 14.627 (5.600) | 4.391(185.700) | 16(5.096.200_ |
| Italia | 8.102(7000) | 103(551.200) | 20(2.838.900) |
| Norvegjia | 435(9.000) | 19(224.000) | - |
| Sllovakia | 2.875(1.800) | - | - |
| Spanja | 8.097(5.000) | 50(809.200) | 17(2.380.000) |
| Suedia | 288(30.000) | 23(342.000) | - |
| Turqia | 2.802(15.8000) | - | 80(226.600) |

Të dhënat nga kjo tabelë vërtetojnë faktin se numri mesatar i banorëve në komunat e Kosovës tejkalon kriteret dhe standardet evropiane. Disa komuna, si, p.sh., Prishtina, Prizreni, Peja etj., janë tejet të stërngarkuara.

Sipas rregulloreve të lartpërmendura mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës përcakton numrin e komunave dhe numrin e anëtarëve të kuvendeve komunale si në vijim:

| | |
|------------------|-----------|
| Prishtinë | 51 |
| Podujevë | 41 |
| Prizren | 41 |
| Suharekë | 41 |
| Gjakovë | 41 |
| Pejë | 41 |
| Mitrovicë | 41 |

| | |
|----------------------|-----------|
| Gjilan | 41 |
| Ferizaj | 41 |
| Malishevë | 31 |
| Glllogoc | 31 |
| Lypjan | 31 |
| Rahovec | 31 |
| Deçan | 31 |
| Istog | 31 |
| Kline | 31 |
| Skënderaj | 31 |
| Vushtrri | 31 |
| Kaçanik | 31 |
| Kamenicë | 31 |
| Viti | 31 |
| Fushë- Kosovë | 21 |
| Obiliq | 21 |
| Shtime | 21 |
| Dragash | 21 |
| Leposaviq | 17 |
| Zubin Potok | 17 |
| Zveçan | 17 |
| Novobërdë | 17 |
| Shterpcë | 17 |

Për ta krahasuar numrin e anëtarëve të kuvendeve komunale, në tabelën në vijim do të paraqesim shënime të numrit të anëtarëve të kuvendeve komunale në disa vende të rajonit dhe të Evropës.

Sipas nenit 36 të projektligjit për vetëqeverisje lokale, numri i anëtarëve në kuvendin komunal të një komune duhet të jetë proporcional, varësisht nga numri i banorëve në komunë.

- i. Nëse komuna i ka deri në *10.000 banorë*, kuvendi i asaj komune përbëhet prej *15* anëtarëve;
- ii. Nëse komuna i ka prej *10.001 deri 20.000 banorë*, kuvendi i asaj komune përbëhet prej *19* anëtarëve;
- iii. Nëse komuna i ka prej *20.001 deri 30.000 banorë*, kuvendi i asaj komune përbëhet prej *21* anëtarëve;
- iv. Nëse komuna i ka prej *30.001 deri 50.000 banorë*, kuvendi i asaj komune përbëhet prej *27* anëtarëve;
- v. Nëse komuna i ka prej *50.001 deri 70.000 banorë*, kuvendi i asaj komune përbëhet prej *31* anëtarëve;
- vi. Nëse komuna i ka prej *70.001 deri 100.000 banorë*, kuvendi i asaj komune përbëhet prej *35* anëtarëve;
- vii. Nëse komuna i ka më shumë se *100.000 banorë*, kuvendi i asaj komune përbëhet prej *41* anëtarëve.

Kuvendi komunal i Prishtinës përbëhet prej *51* anëtarëve.

Tabela nr.4

| Vendi | Numri i ulëseve në këshillat komunale |
|----------------------------|---|
| Austri | 9-37 |
| Belgjikë | 7-55 |
| Bullgari | 11-51(61 për Sofjen) |
| Francë | 9-69(73 për Lionin;101 për Marsejën; 163 për Parisin) |
| Irlandë | 9-51 |
| Itali | 12-60 |
| Norvegji | 11-43 (b) |
| Rumani | 11-35 (65 për Bukureshtin) |
| Spanjë | 5-25 (për komunat deri 100.00 banorë) (a) |
| Suedi | 31-71 (101 në Stokholm) (b) |
| Turqi | 9-55 |
| Mbreteri e Bashkuar | 40-117 |

Siç shihet, gati të gjitha këto vende kanë numër më të madh të përfaqësuesve në kuvendet komunale sesa komunat e Kosovës, duke krahasuar me numrin e banorëve.

Nga ajo që u ilustrua më lart, është shumë e nevojshme t'i qasemi analizës profesionale të bazuar në kriteret e Kartës Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe kriterëve e standardeve të shteteve përfundimtare për madhësinë e komunave në pikëpamje demografike dhe madhësisë së popullatës.

ZGJEDHJET E PARA LOKALE NË KOSOVË

Miratimi i Rregullores 45/2000 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës ka krijuar kushtet për mbajtjen e zgjedhjeve lokale për konstituimin e organeve të para demokratike të qeverisjes lokale .

Rregullorja e UNMIK-ut 39/2000 mbi zgjedhjet lokale në Kosovë ka përqafuar sistemin proporcional të zgjedhjeve me lista të hapura.

Në bazë të kësaj rregulloreje, aktorët politikë, partitë politike, aleancat dhe lëvizjet – iniciativat qytetare, që marrin pjesë në zgjedhje, duhet të paraqesin listën e kandidatëve në njësinë zgjedhore. Kuptohet, ato i paraqesin kandidatët në ato njësi që konkurrojnë, ndërsa qytetarët, zgjedhësit, sipas këtij sistemi, gjatë votimit në fletëvotim kanë pasur mundësi që të përcaktohen apo të bëjnë përzgjedhjen jo vetëm për partinë, por edhe për kandidatin brenda partisë. Sepse gjatë votimit zgjedhësi është dashur që në fletëvotim të cekë partinë dhe numrin e kandidatit.

Sipas Rregullores në fjalë, organet e konstituara pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale ishin me mandat dyvjeçar, ndërsa zgjedhjet e tjera me mandat katërvjeçar.

Zgjedhjet e para demokratike lokale, të mbajtura më 28.10.2000, ishin mjaft demokratike, si për nga numri i votuesve, ashtu edhe për nga zhvillimi i procesit zgjedhor. Kjo kulturë politike e treguar në këtë proces zgjedhor pati një ndikim të madh pozitiv dhe një vlerësim shumë të lartë si zgjedhje më demokratike në Ballkan.*

Ajo çka është me rëndësi-bartja e pushtetit, i cili ashtu ishte i kufizuar nga administrata e UNMIK-ut, nga këshillat komunale të dala si struktura të pushtetit vendor pas përfundimit të luftës në organet e pushtetit të dala pas zgjedhjeve demokratike, ishte shumë demokratike dhe pa asnjë problem.

Rol të rëndësishëm në mbajtjen e zgjedhjeve kanë pasur qytetarët, partitë politike, shoqëria civile, përgatitjet e mira nga KQZ-ja, komisionet komunale zgjedhore, KMLDNJ-ja dhe subjektet e tjera të përfshira në procesin zgjedhor.

ZGJEDHJET E DYTA LOKALE

Zgjedhjet e dyta lokale në Kosovë janë mbajtur në tetor të vitit 2002, pas skadimit të afatit dyvjeçar të mandatit të anëtarëve të përbërjeve të para të

kuvendeve komunale. Këto zgjedhje janë mbajtur në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.11/2002.

Edhe në këto zgjedhje të drejtë pjesëmarrjeje kanë pasur partite politike, aleancat, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur. Mandati i anëtarëve të KK-ve të dala nga zgjedhjet e dyta lokale ka qenë 4 vjet. Për dallim nga zgjedhjet e para lokale, sistemi zgjedhor ka qenë proporcional me lista të mbyllura, e kjo në një farë mënyre është një rikthim mbrapa, ngase qytetarët kanë votuar për parti politike, aleanca dhe iniciativa qytetare e jo për kandidat.

Karakteristikë tjetër e zgjedhjeve të dyta lokale është se përqindja e daljes në zgjedhje nga 79 %, sa ishte në zgjedhjet e para lokale ka rënë në 64 % dhe kjo është reflektim i pakënaqësisë së qytetarëve me punën e institucioneve lokale. Është evidente se pritjet e qytetarëve kanë qenë më të mëdha. Në të dy këto palë zgjedhje është votuar për një njësi zgjedhore.

Në pikëpamje të organizimit dhe administrimit të zgjedhjeve, këto zgjedhje ishin të organizuara mirë dhe të vlerësuara si tejet demokratike.

ZGJEDHJET E TRETA LOKALE

Edhe zgjedhjet e treta lokale janë organizuar në bazë të rregulloreve të UNMIK – ut.

Zgjedhjet janë mbajtur sipas sistemit proporcional me lista të hapura.

Në këto zgjedhje kemi një ramje rapide të votuesve në krahasim me zgjedhjet e kaluara (rreth 43 % të votuesve), ky është treguesi më i mirë se qytetarët kanë humbur besimin në organet e pushtetit.

Për herë të parë në këto zgjedhje kemi zgjedhjen e kryetarit të komunës në mënyrë të drejtpërdrejtë, me çka Kryetari i zgjedhur fiton një legjitimitet të plotë dhe kompetenca ekzekutive.

Sa i përket sistemit zgjedhor në bazë të të cilit janë mbajtur zgjedhjet e lokale mund të konkludohet si vijon :

- Sistemi proporcional i zgjedhjeve, sidomos ai me lista të mbyllura, është më lehte të menaxhohet dhe administrohet , por nuk mundëson lidhjen e drejtpërdrejtë të qytetarit me kandidatë, respektivisht me anëtarin e kuvendit.

- Zgjedhjet, në veçanti ato në nivel lokal, duhet të mbahen sipas njësive zgjedhore me më shumë kandidatë në listë, në mënyrë që qytetarët të votojnë për kandidatin që do t'i shprehte dhe realizonte më mirë interesat e komunitetit të njësisë zgjedhore. Në këtë mënyrë anëtari i zgjedhur në mënyrë më të përgjegjshme do t'i përfaqësonte dhe prezentonte interesat e njësisë zgjedhore të cilat i ka zgjedhur, sidomos kur kihet parasysh fakti se pushteti lokal ballafaqohet me probleme jetike të përditshme të qytetarëve .

Menaxhimi dhe administrimi i zgjedhjeve nga OSBE-ja duhet të kalojë në institucionet vendore.